



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1396 Prot.

Tiranë, më 24.102018

VENDIM Nr. 236, datë 17.10.2018

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10, datë 17.10.2018, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor dhe Konceptin e sondazheve arkeologjike, në kuadër të *projektit "Linja Hekurudhore Kashar-Rinas"*- subjekti "Hekurudha Shqiptare" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor dhe Konceptin e sondazheve arkeologjike, në kuadër të *projektit "Linja Hekurudhore Kashar-Rinas"*-subjekti "Hekurudha Shqiptare" sh.a., realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Subjekti "Hekurudha Shqiptare" sh.a. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të kryejë sondazhet arkeologjike, në zonën e përcaktuar në konceptin e miratuar në pikën 1 të këtij vendimi, të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për zonën tjetër të zhvillimit të projektit "Linja Hekurudhore Kashar-Rinas", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO



Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al